



Prishtinë: 24.10.2013

Kodi i ZRRE-së: V_574_2013

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1004_08_13**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 20.09.2013.

në seancën e mbajtur më datë 24 tetor 2013, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin B.P. (parashtruesi i ankesës A.K. me shifër të konsumatorit: DPR – 11882) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1004_08_13 i datës 21.08.2013.

Arsyetim

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 18.12.2002 kanë dalë te konsumatori ku kanë bërë pranimin e instalimit të njehsorit elektrik si dhe është bërë një përshkrim i gjendjes së konsumatorit lidhur me furnizimin me energji elektrike, po ashtu punëtorët e KEK-ut kanë përshkruar të dhënat rreth tensionit dhe fuqisë së furnizimit me energji për këtë pikë matëse. Pas kësaj punëtorët e autorizuar të kontrollës së KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 04.09.2003 kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit, ku kanë konstatuar se njehsori elektrik xhamin e ka të krisur.

Me datë 18.12.2003 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë dalë te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 2028743 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 4223769, ku edhe e te njëjtin e kanë dërguar ne qendrën e kalibrimit për verifikim.

Gjatë periudhës së muajit 08/2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë dalë te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 4223769 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 4221574, ku është konstatuar se disku i njehsorit nuk sillet (ka frenim) ky konstatim është bërë sipas procesit të kontrollës dhe inspektimit të datës 08.08.2007.

Pas kësaj punëtorët e qendrës së kalibrimit në KEK me datë 24.09.2007 kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 4223769 dhe kanë konstatuar se se njehsori elektrik bllombat shtetërore i ka



në rregull për rreth kapakut të epem nga ana e majtë është futur shiriti filmik ku është penguar puna e diskut si dhe në brendi të njehsorit ka pluhur të shiritit filmik.

Me datë 05.07.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë dal te konsumatori ku kanë bërë inspektimin e pikës matëse te konsumatorit me qëllim të marrjes së të dhënave teknike rreth furnizimit të konsumatorit me energji elektrike.

Departamenti i Faturimit në KEK me datë 14.07.2008 e ka ngarkuar konsumatorin me shifër DPR – 11882 me ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike me anë të faturës DPR08HP06240 në vlerë prej 2,269.69€. Pas kësaj konsumatori ka parashtruar ankesë në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë. Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij dhe duke u thirrur në procedurën e përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike.

Konsumatori pas përgjigjes së KEK-ut me datë 09.10.2008 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas ankesës së konsumatorit ka shqyrtimin e ankesës dhe me datë 21.08.2013 ka nxjerr vendim duke e **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KKDFE që të shkarkojë konsumatorin me shifër DPR – 90027336 nga fatura e rikthimit të humbjeve DPR08HP06240 të datës 14.07.2008 në vlerë prej 2,269.69 €.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 20.09.2013 KEDS-i ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes.

Baza e kundërshtimeve të KEK-ut të theksuara në ankesë është se Sektori i Kalibrimit e ka konstatuar se njehsori padyshim është i keqpërdorur nga ana e konsumatorit ku është konstatuar se bllobat shtetërore i ka në rregull, përreth kapakut të epërm nga ana e majtë është futur shiriti filmik ku është penguar puna diskut si dhe në brendi të njehsorit ka pluhur të shiritit filmik, andaj edhe mbi këtë bazë edhe është llogaritur rikthimi i humbjeve. Në ankesë po ashtu theksohet se konstatimin e kalibrimit e argumenton edhe analiza e rrjedhës së energjisë aktive ku shihet edhe ndryshimi i kilovatëve të shpenzuar para dhe pas vendosjes së njehsorit elektrik, si dhe thekson se jo gjithmonë rrjedha e energjisë së shpenzuar është tregues i vërtetë se nuk ka manipulim me njehsorin elektrik.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24 tetor 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-pas vlerësimit të shkresave të lëndës ka vërejtur se në procesverbalin e KEK-ut nr. nr. 9 të datës 18.12.2003 ku është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik, ku është hequr njehsori elektrik nr. 2028743 dhe është vendosur njehsori elektrik nr. 4223769, njehsori i vendosur (montuar) ka qenë me gjendje të shpenzuar, d.m.th ai njehsori nuk ka qenë njehsor elektrik i ri por ka qenë njehsor elektrike i vjetër, prodhim i vitit 1979 dhe se në procesverbalin e inspektimit dhe kontrollës nr. 01284 të datës 04.09.2003 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë konstatuar se njehsori elektrik xhamin e ka të krisur, atëherë është dashur që të veproj konform dispozitave të nenit 6 të Procedurës së përkohshme për identifikimin dhe shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë elektrike në mënyrë që të mënjanoi parregullsitë në njehsor elektrik, e jo të lejoj njehsorin elektrik për vite të qëndroj në atë gjendje dhe pastaj të konstatoj se kemi shfrytëzim të paautorizuar, andaj KEK nuk ka vepruar konform nenit 6 dhe nenit 3 paragrafi 1 pika f) të Procedurës për identifikimin dhe shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë elektrike.

Pretendimi i KKDFE-së se ndryshim i shpenzimit para dhe pas vendosjes së njehsorit elektrik e konstaton keqpërdorimin nuk qëndron se ngase sipas analizave të bëra shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorit me shifër DPR – 11882 është vërejtur se shpenzimi i energjisë elektrike me njehsor të vjetër dhe me njehsor të ri nuk ka dallim të madh. Sipas mesatares së shpenzimit të



energjisë elektrike me njehsor të vjetër nga periudha kohore 08/2002 e deri në periudhën kohore është 07/2007 është 708.77 kWh/muaj, ndërsa mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsor të ri duke përfshirë periudhën kohore 08/2007 deri në periudhën kohore 07/2013 është 766.26 kWh/muaj, e që në të vërtetë është një shpenzim mesatar i njëjtë në periudha të ndryshme kohore. Kundërshtimi i KEK-ut se vërehet ndryshimi i kilovatëve të shpenzuar para dhe pas vendosjes së njehsorit elektrik nuk qëndron ngase siç u theksua edhe më lartë nuk ka dallim të madh mes shpenzimit të energjisë elektrike para dhe pas ndërrimit të njehsorit elektrik.

Po ashtu pretendimi i KKDFE-së konstatimet e qendrës së kalibrimit se është argument i vlefshëm për ngarkesë të konsumatorit për shfrytëzim të paautorizuar, nuk qëndron ngase sipas nenit 8 paragrafi 8.3 të Procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike theksohet se: *“Konstatimet e parregullsisë funksionale të njehsorit elektrik siç përcaktohet në nenin 3 paragrafi i) të konstatuara në laboratorin e kalibrimit nuk mund të përdoren si provë e vetme meritore për ngarkimin e konsumatorit me faturën e rikthimit të energjisë së humbur”*. Andaj Bordi i ZRRE-së konsideron se konstatimet e laboratorit të kalibrimit nuk janë bindëse dhe të argumentuara mirë, andaj edhe nuk janë konstatime meritore.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KKDFE në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.10.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1004_10_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar